



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:068557  
Datë: 15.02.2024  
Numri i dokumentit: 05334070

A.C.nr.867/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj kryetar, Faton Ademi dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtar, në çështjen juridike të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim D. S. nga Prishtina, kundër të paditurit S. R. nga Fshati R., Komuna Shtime, të cilën e përfaqëson me autorizim av. B. S., për shkak të rimbursimit të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.944/2020 datë 02.12.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 07.02.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I. PJESËRISHT aprovohet si e themeltë ankesa e të paditurit S. R., nga fshati R., Komuna Shtime, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.944/2020 datë 02.12.2020, në pikën I dhe II NDRYSHOHET, ashtu që gjykohet si në vijim: Pjesërisht aprovohet kërkesë padia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) me seli në Prishtinë dhe DETYROHET i padituri S. R., nga fshati R. Komuna Shtime që paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit në Prishtinë t'i paguaj shumën prej 14,474.00 euro, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 22.07.2010, me kamatë 8 % nga dita e paraqitjes së padisë dt.15.06.2020 e deri në pagesën përfundimtare, në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm. Pjesa tjetër e kërkesë padisë së paditësit përtej shumës së aprovuar e deri në shumën e kërkuar dhe atë shumën prej 2,035.00, refuzohet si e pa bazuar.

II. pika III e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.944/2020 datë 02.12.2020, mbetet e pa shqyrtuar.

## A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.944/2020 datë 02.12.2020, ka vendosur: I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë. II. DETYROHET i padituri S. R. nga fshati R., Komuna Shtime që paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit në Prishtinë t'i rimburoj shumën prej 16,302.60 EURO, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 22.07.2010 në fshatin V. Komuna Shtime, dhe atë me kamatë 8 % nga dita e paraqitjes së padisë dt.15.06.2020 e deri në pagesën përfundimtare, në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm. III. DETYROHET paditësja që të paguajë shumën prej 100 € në emër të taksës për padi në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Kundër pikës I dhe II të këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i padituri, për shkak të: Shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, Konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së shkallës së Apelit që ta aprovoj ankesën e të paditurit si të bazuar dhe aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj dhe ta refuzoj kërkesë padinë e paditëses apo të njëjtin ta prishë dhe lëndën ta kthejë në Gjykatën e shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar paditësja.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe gjeti se:

*Ankesa e të paditurës, është pjesërisht e themeltë.*

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, me datë 15.07.2020, në gjykatën e shkallë së parë, ka paraqitur padi ndaj të paditurit S. R. nga fshati R., Komuna Shtime, për shkak të regresimit të dëmit në vlerë prej 16,302,6 euro.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, pas dëgjimit të palëve ndërgjyqëse si dhe administrimit të provave, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.944/2020 datë 02.12.2020, me të cilin e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur me konkretisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ndër të tjera ka arsyetuar se: Lidhur me bazën juridike rreth themelësisë së kërkesëpadisë së paditësit, Gjykata ka gjetur se e njëjta bazohet në Ligjit Për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autpërgjegjësia Nr.04/L-018, dhe atë fillimisht bazuar në nenin 18 paragrafi 1, në të cilën parashihet e drejta e personit të dëmtuar ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja. Në ndërlidhje më këtë e drejta e Byrosë (BKS-së) për rimbursimin e dëmit rrjedh nga i njëjti nen paragrafi 4, në të cilën përcaktohet *''Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat''*.

Më tej ka arsyetuar se: Nga provat e administruara gjykata në emër të demit material e aprovoi kërkesën në shumën prej 16,302.60 Euro dhe e vlerësoi si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit. Shuma e aprovuar e kërkesëpadisë u bazuar në transferi bankar i BKS me të cilin vërtetohet se BKS për N. L. ka bërë pagesën në shumë prej 16,202 euro, si dhe në emër të ekspertizës kanë paguar 100 euro, çka vije deri te shuma prej 16,302 euro, dokumente të cilat gjykata i vlerësoi si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore, si dhe dokumentacionit i cili gjendet në shkresat e lëndës, të cilat janë administruar si prova në këtë çështje juridike, sepse të njëjtit në po këtë shumë e kanë kompensuar dëmin dhe posedojnë faturën, gjykata pretendimin e tillë e vlerësoi si të pajustificueshëm dhe të paarsyeshëm, dhe gjykata ia ka falur besimin ekspertizës së punuar nga eksperti.

Më tej ka arsyetuar se: Gjykata me rastin e vendosjes pati parasysh edhe pretendimet e të paditurit i cili e ka kundërshtuar lartësinë e dëmit të shkaktuar në automjet, mirëpo gjykata i ka falur besimin dokumenteve që gjenden në shkresat e lëndës dhe dokumentacionin përkatës, pasi janë dokumente zyrtare dhe të lëshuara nga organet kompetente. Rrjedhimisht, bazuar në këto argumente (sa i përket gjendjes faktike dhe aplikimit të së drejtës material) Gjykata ka konstatuar se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe për të njëjtën e ka obliguar të paditurin ta bëjë rimbursimin e dëmit në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite, ashtu siç është urdhëruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në lidhje me kamatën e gjykuar ka vendosur në kuptim të nenit 382 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në kuptim të nenit bazë të neneve 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson së përkundër faktit që aktvendimi i ankimuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as me Shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të pretenduara me ankesën nga ana e të paditurve, mirëpo gjykata e Apelit gjen se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes është marre me zbatim të gabuar të drejtës materiale, për shkak se sipas vlerësimit të kësaj gjykate gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë nuk korrespondon drejtë me provat nga shkresat lëndore, ku për pasojë më rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të ankimuar ka ardhur gjer tek zbatimi i gabuar i të drejtës materiale. Gjykata ankimore me anë të vlerësimit ndryshe të shkresave dhe provave të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor nga gjykata e shkallës së parë konstaton pjesërisht një gjendje faktike tjetër nga ajo e cila është konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e së cilës gjendje faktike kjo gjykatë vjen në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar, me çka në rastin konkret ka gjetur se ka kushte që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ku edhe ka vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Gjykata e Apelit vlerëson pjesërisht të bazuara pretendimet ankimore të të paditurit në lidhje me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që e njëjta gjen se paditësja me padi ka kërkuar regresimin e dëmit të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 22.07.2010, i shkaktuar nga këtu i padituri e i cili në kohën e shkaktimit të aksidentit nuk kishte mbulesë sigurimi, nga i cili aksident dëme material dhe jo material ka pësuar e dëmtuara N. L., e cila në procedurë kontestimore është kompensuar nga këtu paditësja sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr. 602/2011 të datës 16.12.2014, përmes së cilit aktgjykim është detyruar e paditura BKS, që të kompensoj dëmin paditëses N. L. në shumë prej 14,000.00 euro me kamat prej 3,5% duke filluar nga paraqitja e padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 1,702.00 euro. aktgjykim ky i cili është ndryshuar sipas aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AC.nr. 819/2015, datë 18.11.2019, duke e detyruar të paditurën BKS (këtu paditëse) që të kompensoj paditësen N. L. në shumë prej 12,060.00 euro me kamat si për mjetet e deponuara në afat prej një viti pa destinim të caktuar si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1,702.00 euro. fakte këto të vërtetuara nga aktgjykimet e cekura si më lartë.

Gjykata e Apelit, duke analizuar provat që gjinden në shkresat e lëndës konstaton se paditësja BKS, dëmin e gjykuar sipas aktgjykimit të gjykatës së Apelit AC.nr. 819/2015, datë 18.11.2019, i ka paguar paditëses me datë 04.02.2020 sipas urdhër transferit bankar shumë prej 16.202.00 euro si dhe shumë prej 100 euro për ekspertizën, e cila shumë e paguar në lartësi prej 16.202.00 euro, ka të bëjë: 12,060.00 euro në emër të dëmit material dhe jo material, shumë prej 1,702.00 në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore si dhe shumen prej 2.747.00 në emër të kamatës së gjykuar, fakte ky i vërtetuar nga komunikimi për mes e-mail adresës së personit përgjegjës të paditurës BKS (paditëses) dhe të autorizuarit të paditëses N. L..

Gjykata e Apelit duke analizuar provat që gjinden në shkresat e lëndës e sidomos ekspertizën financiare të ekspertes A. K. B. e punuar në procedurë përmbarimore P.nr. 22/2020 e datës 27.01.2020, ka vërtetuar se kamata e gjykuar sipas aktgjykimit të gjykatës së Apelit AC.nr. 819/2015, datë 18.11.2019, për shumën e dëmit prej 12,060.00 euro “me kamat si për mjetet e deponuara në afat prej një viti pa destinim të caktuar” është shuma prej 712.00 euro e akumuluar nga data e parashtrimit të padisë 16.12.2014 e deri në përpilimin e ekspertizës dhe jo shuma prej 2,747.00 euro siç pretendon paditësja që është paguar. Andaj, duke u bazuar në nenin 136.1 të LMD-së, i cili parasheh që “*kush i shkaktonte tjetrit dëmin, ka për detyrë të ia kompensoi, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”. Andaj, sipas kësaj dispozite, i padituri nuk është në obligim për pagesën e kamatës në shumë prej 2,035.00 euro, pasi që i njëjti nuk e ka shkaktuar këtë dëme në lartësinë e cekur më lartë dhe se paditësja nuk ka ofruar asnjë provë për të vërtetuar se si ka ardhë deri te llogaritja e kamatës në lartësinë e paguar prej 2,747.00 euro. Andaj në rastin konkret i padituri duke u bazuar në përgjegjësinë e tij, ka për obligim të paguaj shumë prej 712.00 euro të llogaritur sipas ekspertizës se cekur më lartë. Andaj, në rastin konkret shumen prej 2.035.00 euro e refuzoj si të pa bazuar.

Gjykata e Apelit, konstaton se nga provat e administruara nga gjykata e shkallës së parë, është vërtetuar se i padituri është përgjegjës për kompensimin e dëmit material këtu paditëses në emër të regresit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të cekur më lartë pasi që është vërtetuar se i padituri është shkaktarë i këtij aksidenti i cili fakt është vërtetuar nga ekspertiza e komunikacionit dhe si rrjedhojë edhe i shkaktimin e këtij dëmi dhe i njëjti është i detyruar që paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve t’ia paguaj shumë prej 14,474.00 euro, pasi që me pa

mëdyshje është vërtetuar se ky dëm është shkaktuar nga këtu i padituri në aksidentin e trafikut të datës 22.07.2010, i cili aksident ka ndodhur me fajin e këtu të paditurit dhe të cilin dëm paditësja e kishte kompensuar tek personi i tretë. Sipas nenit 136.1 të LMD-së, i cili parasheh që “*kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë të ia kompensoi, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”. Sipas nenit 18 par. 1 i Ligjit Për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia Nr.04/L-018 i cili parasheh që “*Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësive, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja*”, ndërsa sipas paragrafit 4 të po të njëjtit nen është paraparë se “*. Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat*”. Andaj, në rastin konkret, duke qenë se paditësja ka kompensuar dëmin e shkaktuar nga këtu i padituri në një procedurë tjetër kontestimore dhe se i padituri në kohën e aksidentit nuk kishte mbulesë sigurimi, të njëjtës i njihet e drejta për regrese nga shkaktari i aksidentit në rastin konkret i padituri.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por gjeti se të njëjtat pretendime nuk kanë ndikim në vendosjen ndryshe në ankesën e të paditurit.

Sa i përket vendimit për kamatën e gjykuar nga gjykata e shkallë së parë, edhe gjykata e Apelit e përkrah një vendim të tillë pasi që kamata e gjykuar është në pajtueshmëri të plotë me nenin 382 të LMD-së.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën II. të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në dispozitat e nenit 194 të LPK-së, duke mos e shqyrtuar pikën III të aktgjykimit të ankimuar, pasi që për këtë pjesë nuk kishte pretendime ankimore.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 195.1 pika e) të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK).

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
A.C.nr.867/2021 datë 07.02.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,  
Besnik Bislimaj, d.v